



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 351-4503/2024

Klinë, datë 12/07/2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nr.04/L-042 publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.18/2011, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e menaxherit të kontratës, kryetari i Komunës së Klinës, lëshon **këtë**:

V E N D I M

1. **LEJOHET**, kryerja e punëve shtese sipas kërkesës së menaxherit të projektit- kontratës 01-351-14134/23 të datës 27.04.2023 “Asfaltimi i Rrugëve dhe Infrastrukturës Nëntokësore Volljakë- Sferkë- Qupevë”. Punët shtesë lejohen brenda limiteve dhe rregullave ligjore të prokurimit publik.
2. Arsyeja e lejimit të punëve shtese perkatasisht dhënia e këtij pelqimi, behet më kërkesë të menaxherit, për shtimin e kryerjes së punëve të paparashikuara më qëllim të realizimit të projektit në teresi sipas standardeve.
3. Ky vendim lëshohet më kërkesën e menaxherit të projektit e cila është pjese perberese e këtij vendimi së bashku më paramasat dhe parallogarite e punëve shtese të cilat nuk mund të kalojne 10 % të vlerës së përgjithshme të projektit.
4. Zbatimi i ketij vendimi behet nga ana e zyres së prokurimit në bashkepunim më DSHPE dhe operatorin kontraktues.

Të njoftohën:

- Zyra e Prokurimit;
- DUMM- menaxheri i kontratës
- Punekryesi, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,

Zenun Elezaj

